



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SHK.II.nr.974/23

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Limak Kosovo International Airport J.S.C” SH.A., me seli në Prishtinë, Qyteza Pejton, Mbreti Zogu 1 nr.09, me NRB: 810803868, për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje KPPP.nr.1343/22, të datës 30.05.2023, me datën **24.10.2023**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “Limak Kosovo International Airport J.S.C” SH.A., me seli në Prishtinë, Qyteza Pejton, Mbreti Zogu 1 nr.09, me NRB: 810803868, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje KPPP.nr.1343/22, të datës 30.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1343/22, të datës 30.05.2023 në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Limak Kosovo International Airport J.S.C” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.999/21 të datës 28.09.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S.Bogaj. Ndërsa në piken II të dispozitivit ka vendosur që të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.999/21 i datës 28.09.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka parashtruar ankesë (*me pretendimet si në ankese*), duke propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e debitorit ndaj aktvendimit KPPP.nr.1343/22 të datës 30.05.2023 të Gjykatës Komerciale, Dhomave të shkallës së parë.

Përgjigje në ankese nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën

Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se kreditori Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me datën 28.09.2021 ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit “Limak Kosovo International Airport J.S.C” SH.A., me seli në Prishtinë, Qyteza Pejton, Mbreti Zogu 1 nr.09, me NRB: 810803868, ku përmbaruesi privat ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.999/21 të datës 28.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues-Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01-14-66/2020-2 të datës 03.03.2021 dhe ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit përmbarimor, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 35,000.00 €, në emër të masës ndëshkimore, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, në të cilin ka deklaruar se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, duke shtuar se i njëjti është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër dhe ka humbur efektin e tij juridik. Ka theksuar se kreditori vendimin për gjobë e ka marrë duke u mbështetur në nenin 11 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ UA 07/2021 për Gjoba, i cili qartazi është në kundërshtim të plotë me Ligjin për Kundërvajtjet dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese me numër reference. AGJ. 1565/20 të datës 05.05.2020 (KO.nr.61/20), andaj rrjedhimisht edhe ky vendim është i kundërligjshëm. Gjykatës i ka propozuar të aprovohet në tërësi prapësimi dhe të priset Urdhri Përmbarimor 999/21 i datës 28.09.2021.

Kreditori me përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar për shkak se propozimi për përmbarim është paraqitur pasi që debitori nuk e ka përmbarues detyrimin për pagesën e gjobës të shqiptuar me vendim të formës së prerë të TEIP, andaj kreditori është detyruar që të njëjtin ta kërkojë përmes procedurës së përmbarimit. Po ashtu i ka kundërshtuar thëniet e debitorit se në këtë rast mungon baza juridike për përmbarim sepse procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat e LPP-së, si dhe Inspektorati i Punës i ka zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë dhe drejtë është vërtetuar gjendja faktike. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi Urdhrin Përmbarimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkak se si në vijim: Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Po ashtu, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se ka vlerësuar dokumentin përmbartimor Vendimin Nr. 01-14-66/2020-2 të datës 03.03.2021, në bazë të të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimi Nr. 01-14-66/2020-2 i datës 03.03.2021, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Rrjedhimisht, Gjykata Komerçiale, dhomat e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret Vendimi Nr.01-14-66/2020-2 i datës 03.03.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbartueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Vendimi Nr.01-14-66/2020-2 i datës 03.03.2021, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 30.07.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 30.07.2021.

Gjykata Komerçiale vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përmbartimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore të debitorit se lejimi i këtij përmbartimi është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, ky pretendim nuk qëndron ngase gjykata e cakton përmbartimin vetëm në bazë të titullit përmbartues siç e përcakton dispozita e nenit 24 dhe 27 të LPP-së. Andaj, Gjykata komerçiale vlerëson se në këtë rast sipas vlerësimit të shkresave të lëndës gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerçiale po ashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, për arsye se me dispozitën e nenit 21 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore përcaktohet se *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Në rastin konkret në bazë të dokumentit përmbartimor Vendimin Nr. 01-14-66/2020-2 të datës 03.03.2021 i përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga neni 27 par.1 të LPP-së, pasi që në vendimin përmbartimor është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e

debitorit dhe kur e ka lënë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr.999/22 të dt.28.09.2021 të lejuar nga përbaruesi privat.

Nuk qëndrojnë pretendimet e tjera të debitorit lidhur me gjendjen faktike, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, gjykata në procedurë përbarimor i përmbahet parimit të rigorozitetit formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për lejimin e përbarimit dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata e shkallës i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Po ashtu, Kjo Gjykatë i vlerësoi pretendimet e tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk kane mbështetje nga shkruesat e lëndës, ngase procedura përbarimor i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore të debitorit për të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta dhe rrjedhimisht ankesa e debitorit rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SHK.II.nr.974/2023, me datën 24.10.2023**

**Gj y q t a r i,
Ramush Bardiqi**